

VENDIM
Nr. 550, datë 1.10.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E
ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN
DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- Z. Blendi Gonxhja, ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- Z. Andis Salla, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Z. Ervin Demo, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama